# AKT-THEMELIMI
# I SHOQERISE TREGETARE E NDERTIMI
# "SPARTAK SA" SH.P.K

**Sot ne daten 3 Prill 2001 ne qytetin e Bilishtit themelohet shoqeria tregetare dhe e ndertimit me ortak te vetem Spartak Meraku i datelindje 1980 banues ne qytetin e Bilishtit me Nr.pasaporte 0715438 ne kushtet e meposhtme:**

## Neni 1

**Shoqeria tregetare dhe e ndertimit"Spaktak SA" sh.p.k themelohet ne konformitet me ligjin 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".Ajo eshte person juridik shqiptar. Selia ndodhet ne qytetin e Bilishtit,zona industriale.**

## Neni 2

**Veprimtaria shoqerise bazohet ne normat e ketij akti themelimi,statutit te shoqerise,legjislacionit shqiptar.**
**Ajo eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar(SH.P.K).Ortaku i vetem mban pergjegjesi per detyrime t e shoqerise ne masen e kapitalit te saj.**

## Neni 3

**Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke dhe i takon ortakut te vetem 100%.**

## Neni 4

**Objekti i shoqerise eshte:Ndertim objekte nje dhe disa kate,punime betoni dhe beton armeje,punime dhe germime dheu,restaurim te veprave ujitese e bonifikuese,ndertime dhe rikonstruksione te ujesjellsave,tregetim materiale ndertimi,tregeti me shumice dhe pakice artikujsh industriale,blektorale dhe bujqesore,hidrosanitare dhe elektroshtepiake,transport ku veprimtaria e transportit do te jete eksport-import.**
**Objekti mund te shtohet me vendim te mbledhjes se ortakut te vetem.**

## Neni 5

**Afati i veprimtarise se shoqerise eshte mbi 10 vjet duke filluar nga data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar.**
**Ai mund te zgjatet me vendim te . Ortakut te vetem.**

## Neni 6

**Ortaku i vetem ka te drejte te transferoje kapitalet e shoqerise ne cdo forme qe cmohet e arsyeshme.**
**Transferimi i kapitalit behet me akt noterial,ndryshe eshte i pavlefshem.**

## Neni 7

Fitimet e realizuara nga shoqeria dhe pasurite e vena gjate veprimtarise se shoqerise i perkasin teresisht Ortakut te vetem Spartak Meraku.
Fitimi eshte lirisht i transferueshem edhe jashte shtetit.

## Neni 8

**Ortaku i vetem ka keto detyrime:**

*Te rregjistroje shoqerine ne rregjistrin tregetar e te marre lejen e ushtrimit te profesionit.
*Te derdhe kuotat e kapitalit fillestar.
*Te siguroje mjetet dhe mjediset ku do te ushtrohet veprimtaria e shoqerise.
*Te siguroje fuqi punetore te specializuar e te persose kualifikimin e tyre.
*Te krijoje kushtet e nevojshme per mbrojtje e punetoreve ne pune.
*Te dherdhe sigurimet e nevojshme ne organet e Sigurimeve Shoqerore.
*Te menaxhoje dhe ekspozoje veprimtarine e shoqerise.

## Neni 9

**Organet drejtuese te shoqerise jane:**
* [illegible]e Ortakut te vetem.
*Administratori
*Ortaku i vetem mund te caktoje dhe ekspert kontabel.

## Neni 10

Ortaku i vetem duhet te ruaje sekretin e themelimit te shoqerise.Te punesuarit pergjigjen per demet qe i shkaktojne shoqerise.

## Neni 11

Ortaku i vetem ndalohet te marre pjese ne shoqeri te tjera qe nuk kane te njejtin objekt te veprimtarise.

## Neni 12

Mosmarreveshjet ose pavlershmerite e shoqerise zgjidhen ne Gjykaten kopetente dhe Gjykata kopetente eshte Gjykata e rrethit te Korces.

## Neni 13

**Akti i themelimit pasi u lexua nga ortaku i vetem themelues u nenshkrua perpara noterit.**

**Ortaku i vetem themelues**

**Spartak Meraku**

**Republika e Shqiperise**
**Dhoma e notereve**
**Korce**
**Nr. rep.** 145 **Nr.kol** 70

**Korce me** 6. 4 **2001**

## Vertetim nenshkrimi

**Sot ne daten 3 Prill 2001 u paraqit para meje ortaku i vetem Spartak Meraku me identitet te shenuar ne aktin e themelimit,i cili e nenshkroi ne pranine time kete akt.**

**Noteri**

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

# STATUTI
# I SHOQERISE TREGETARE E TE NDERTIMIT "SPARTAK SA" SH.P.K

Sot ne daten 3 Prill 2001 ne qytetin e Bilishtit, Ortaku i vetem themelues Spartak Meraku i biri i Shyqyriut i datelindjes 1980,banues ne qytetin e Bilishtit me nr.pasaporte 0715438 deklaron se shoqeria e themeluar prej tij do te funksionoje sipas ketij statuti:

## Neni 1

**Pozita juridike**

**Shoqeria tregetare dhe e ndertimit "Spartak SA"SH.P.K rregullon poziten e saj juridike,ne marredheniet midis ortakut te vetem dhe organeve te shoqerise,te punesuarve dhe personave te trete,kohen dhe menyren e veprimtarise se saj bazuar ne ligjin 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare",Legjislacionin ne Republiken e Shqiperise,normat e statutit dhe te kontrates se themelimit.**

## Neni 2

**Veprimtaria dhe selia**

**Shoqeria do ta zhvilloje veprimtarine ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj.**
**Selia ndodhet ne qytetin e Bilishtit,zona industriale.Ajo mund te ngreje dege ,agjensi dhe ne qytete te tjera ose jashte Republikes se Shqiperise.**

## Neni 3

**OBJEKTI**

**Objketi i veprimtarise se shoqerise eshte:**
**Ndertime objekte nje dhe disa kateshe,punime betoni dhe betonarmeje,punime dhe germime dheu,restaurime te veprave ujitese dhe bonifikuese,ndertime dhe rikonstruksione ujesjellisash,tregetim materiale ndertimi,tregetim me shumice dhe pakice te artikujve industriale,ushqimore,blektorale,hidrosanitare dhe elektro shtepiake,transport ku veprimtaria e transportit eshte eksport-import.**
**Objekti mund te shtohet me vendim se Ortakut te vetem.**

## Neni 4

**Emertimi**

**Shoqeria do te paraqitet ne qarkullimin civil me emertimin "Spartak SA".**
**Ky do te jete dhe emertimi i shkurtuar i saj.**
**Ajo do te kete stemen e saj miratuar sipas rregullave.**

## Neni 5

**Lloji i Shoqerise**

**Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "SH.P.K"**
**Oraku i vetem mban pergjegjesi per humbjet deri ne kufirin e kapitalit te invenstuar prej tij.**

## Neni 6

### Pasurite

**Pasurite e krijuara gjate veprimtarise se shoqerise jane prone e Ortakut te vetem themelues ne raport me kapitalin e invenstuar prej tij.Ato mund te tjetersohen,te lihen peng ose te hipotekohen me miratim te [illegible] se Ortakut te vetem.**

## Neni 7

### Fitimi

**Fitimi i realizuar nga shoqeria i perket teresisht Ortakut te vetem.Ai eshte lirisht i disponueshem dhe mund te transferohet edhe jashte shtetit.**

# II.TE DREJTAT DHE DETYRAT

## Neni 8

### Te drejtat

**Ortaku i vetem ka keto te drejta qe i realizon nepermjet vendime qe merr Asamblea e Ortakut te vetem.**
**1.Administron vlerat ekonomiko-financiare dhe intelektuale te shoqerise.**
**2.Merr pjese vete ose me ane perfaqesuesi ne kontrollin e rezultateve ekonomike e financiare.**
**3.Terheq e verifikon dokumentat e shoqerise per 3 vjetet e fundit.**
**4.Therret mbledhjen e Asamblese se Ortakut te vetem e cakton kur eshte rasti rendin e dites.**
**5.Eshte i pavarur ne dhenien e vendimeve e votimin e vendimeve.**

## Neni 9

### Detyrat e ortakut te vetem

**Ortaku i vetem ka keto detyra kryesore:**
**1.Nenshkruan kapitalin themelor te shoqerise.**
**2.Derdh kuotat suplementare e kushtet e vendosura nga statuti.**
**3.Ruan sekretin e vlerave krijuese e materiale.**
**4.Informon per permiresimin e prodhimit e drejtimit te shoqerise.**
**5.Respekton detyrimet qe burojne nga kontrata e themelimit.**
**6.Perpiqet per gjetjen e rritjen e nivelit te specialisteve.**

## III.KUSHTET EKONOMIKE

### Nein 10

**Veprimtarie ekonomike**

Veprimtaria e shoqerise bazohet ne kerkesat ekonomise se tregut dhe ka per qellim fitimin.Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimin e llogarise dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.Llogaria e saj mbahet ne Shqiperi ne monedhen e vendit ose te huaj.

### Neni 11

**Kapitali**

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke.Ajo i perket ortakut te vetem Spartak Meraku 100%.Administratori mban dokumentin vertetues per sasine e kapitalit te te depozituar.

### Neni 12

**Pronesia**

Shoqeria behet pronare e pasurise se lujteshme dhe te palujtshme e cila i perket Ortakut te vetem.

### Neni 13

**Heqja dore**

Ortaku i vetem mund te heqe dore ne favor te bashkeshortes,paraardhesve ose pasardhesve te tij.Heqja dore behet ne favor te personave te trete.Keta jane te detyruar te mos terheqin sasine e kapitalit per 6 muaj nga data e realizimit te ketij veprimi juridik.

### Neni 14

**Transferimi i kapitalit**

Kapitali themelor mund te transferohet lirisht per ortake te tjere,trashgimtaret ligjore ose testamentare,bashkeshortja ne rastin e zgjidhjes se marteses.Ai transferohet edhe tek persona te trete.
Personat qe perfitojne nga transferimi detyrohen qe 6 muaj te mos kerkojne te terheqin kapitalin.

## Neni 15

## Menyra e transferimit

Transferimi i pjeseve te kapitalit themelor vertetohet me akt noterial.Ne te kunderten eshte i pavlefshem.

## Neni 16

## Vdekja. Paatfesia. Falimentimi

Shoqeria nuk prishet me vdekjen,falimentimin ose paaftesine e ortakut te vetem.Pjesa e tij mund te blihet nga ortake te tjere ,ne qofte se trashgimtaret e tij nuk e deshirojne ose jane te mitur.Mosmareveshjet per vleren e kapitalit zgjidhen nga Gjykata.

## Neni 17

## Zmadhimi i kapitalit

Kapitali themelor mund te zmadhohet kur e kerkojne interesat e shoqerise duke depozituar kuota suplementare sipas vendimit te Asamblese se Ortakut te vetem.Menyra e zmadhimit te kapitalit themelor me para ose ne natyre percaktohet me ligjin "Per shoqerite tregetare".

## Neni 18

## Zvogelimi i kapitalit

Kapitali themelor mund te zvogelohet me miratim te Ortakut te vetem.Projekti i zvogelimit i paraqitet Ortakut te vetem jo me vone se 30 dite para mbledhjes se Asamblese.Kreditoret nuk duhet te demtohen ose te ndjehen te pasigurte nga ky zvogelim,perndryshe shpallet i pavlefshem nga Gjykate.

## Neni 19

## Nxjerrja e fitimit

E ardhura neto qe rezulton pasi zbriten:
shpenzimet,amortizimi,pagat,shperblimet,taksat e tatimet dhe invenstimet perben fitimin.
Fitimi i jepet Ortakut te vetem dhe perdoret per qellimet e tij.

## Neni 20

Pasurite e shoqerise vleresohen ne momentin e krijimit te tyre ne monedhe te vendit ose te huaj duke u pasquruar ne bilancin e saj.
Pasurire e vleresuara nuk rivleresohen.
Bilanci vjetor paraqitet jo me vone se 31 marsi i vitit pasardhes.
Forma e tij percaktohet nga Administratori ne pajtim me formen e miratuar ne Republiken e Shqiperise.

## IV.ADMINISTRIMI

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakut te vetem.Shoqeria me miratim te se Ortakut te vetem vendos dhe emerime honorifike te anetareve te saj.
Asambleja vendos me shumice votash per te gjitha problemet qe shqyrtohen me perjashtim te ndryshimeve ne statut qe vendoset nga Ortaku i vetem.
Ortaku i vetem mund te marre pjese ne mbledhje dhe me ane te perfaqesuesit (mandatmbajtesit).

## Neni 22

### Thirrja e mbledhjes

Mbledhja e thirret nga Administratori i cili percakton dhe rendin e dites.Ortaku i vetem mund te kerkoje ndihmen e nje eksperti kontabel per problemet qe shqyron . Per cdo ceshtje qe shqyrtohet mban procesverbal i cili qendron ne seline e shoqerise.

## Neni 23

### Kopetencat . Delegimi

e Ortakut te vetem shqyrton te gjitha ceshtjet e rendesishme si bilancet vjetore,shtimin dhe pakesimin e kapitalit themelor,krijimin e filialeve e te zyrave.
Asamblea mund tu delegoje organeve me te ulta te drejtat dhe detyrat te kopetences se saj, te cilat organet varese duhet t'i plotesoje.

## Neni 24

### Administratori

Administratori i shoqerise eshte z.Spartak Meraku i cili ka keto kopetenca:
-Miraton llogarite ekonomike mbas perpunimit te bere.
-Pergatit raportin vjetor te veprimtarise se shoqerise
-Paraqet ne Asamble projektin e ndryshimit te kapitalit themeltar.

-Propozon vendin e kohen e hapjes se zyrave,filialeve.
-Propozon ne Asamble ose nxjerr akte lidhur me organizimin e punes.
-Propozon ekspert kontabel dhe likujdatorin e shoqerise.
-Perfaqson shoqerine ne mosmarreveshje me administraten shteterore,pushtetin,lokal,shteteror,organet gjyqesore dhe te tretet.
-Lidh kontraten individuale te punes dhe ate kolektive si dhe me te tretet.
-Organizon dhe drejton veprimtarine e shoqerise.
-Paraqet raportin e prishjes se shoqerise .

## V.MAREDHENIET E PUNES

### Neni 26

**Punesimi**

Marredheniet e punes rregullohen nga legjislacioni i punes,dispozitat e statutit te shoqerise.
Punesimi realizohet me anen e kontrates individuale te punes.Marredheniet midis shoqerise dhe sindikatave rregullohen me anen e kontrates kolektive.

### Neni 27

**Kontrata e punes**

Kontrata e punes rregullon keto marredhenie:
-Kushtet per t'u punesuar ne shoqeri.
-Lloji i punes qe do te kryhet,profesionet ndihmese.
-Koha ditore e punes,puna e nates dhe ditet e festave dhe te pushimit dhe jashte kohes normale .
-Shperblimi i punes edhe per kohen jashte kohes se punnes normale.
-Pergjegjesite e paleve per mosrespektimin e kontrates.

### Neni 28

**Prishja e shoqerise**

Shoqeria prishet ne perfundimin e afatit ose veprimtarise per te cilen u krijua.
Ajo mund te prishet para perfundimit te afatit kur:
*Nuk rezulton kontabel 2 vjetet e fundit radhazi.
*Kur ortaku i vetem nuk respekton te drejtat dhe detyrat e percaktuara ne aktin e themelimit dhe te statutit.
*Kur vendos gjykata kopetente.
*Me kerkese te Ortakut te vetem.